A ËSHTË RASTI PËR NJË RRITJE TË MËTEJSHME TË KAPITALIT MINIMAL NË SHQIPËRI?

Dr. Erjon Luçi[1]
Departamenti i Kërkimeve

1. Mbikëqyrja bankare në vendet në tranzicion

Rritja e madhe e numrit të bankave me rrezik të lartë, sidomos në vendet e ish Bashkimit Sovietik, si pasojë e politikës liberale të licencimit në fillim të tranzicionit, rriti ndjeshëm rrezikun e krizave bankare. Edhe vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, që u mbështetën më shumë në konkurrencën më "të sigurt" të bankave të huaja, kanë pasur raste të humbjeve të mëdha prej këtyre bankave (për shembull në Hungari) apo raste mashtrimi (për shembull në Poloni) (Bonin etj., 1998). Me privatizimin e bankave shtetërore, merr fund dhe sigurimi i nënkuptuar i depozitave nga ana e qeverisë dhe mundësia e panikut bëhet më reale. Kështu që, rregullimi dhe mbikëqyrja bankare që mund të zvogëlojë rreziqet e krizave në vendet në tranzicion merr një rëndësi të veçantë. Një krizë bankare mund të zhvlerësojë të gjitha arritjet e reformave bankare dhe mund të vështirësojë shumë rekuperimin e besimit të kursimtarëve dhe të investitorëve të huaj.

Në gjysmën e dytë të viteve 1990, shumica e vendeve në tranzicion adoptuan politika shumë më të shtrënguara licencimi, sidomos në lidhje me shumën e kërkuar për kapitalin minimal, krahasuar me fazën e parë të tranzicionit (Hanson dhe Tombak, 1999; Barisitz, 2000a, b, 2001; Schardax dhe Reiniger, 2001; Green dhe Petrick, 2002). Si rezultat, licencat e shumë bankave të vogla të nënkapitalizuara u revokuan dhe numri i bankave u zvogëlua në shumë vende, sidomos në ato të ish Bashkimit Sovietik. Për shembull, në Rusi numri i bankave gati u përgjysmua në periudhën nga 1995 në 2000. Megjithë këto masa shtrënguese, shumë vende nuk arritën të shmangnin krizat bankare.

[1] Do të desha të falenderoja Erjona Suliotin, Aida Deliun dhe Teuta Baletën si dhe Drejtorër dhe Zv. Drejtorët e departamenteve të Bankës së Shqipërisë për ndihmën e tyre në përgatitjen e këtij materiali. Çdo koment apo sugjerim është i mirëpritur.

Krizat bankare që goditën vendet Balltike lidhen pjesërisht me përkeqësimin e papritur të kushteve makroekonomike por edhe me kuadrin jo të plotë ligjor dhe rregullator dhe me pamundësinë për të forcuar mbikëqyrjen e shëndoshë (Hansson dhe Tombak, 1999). Ndërkohë që, nuk ishin vetëm bankat e vogla dhe të nënkapitalizuara që patën vështirësi, por edhe bankat e mëdha (joshtetërore) rreziku i kolapsit të të cilave ishte nënvleftësuar dhe/ose mbikëqyrja dhe rregullimi i tyre ishte i vështirë, për shkak të lidhjeve politike që ato kishin. Krizat bankare në Rumani dhe në Bullgari përfshinë si bankat private ashtu dhe ato shtetërore, aktivet e të cilave, për shkak të keq-administrimit dhe të kushteve të pavaforshme makroekonomike, u përkeqësuan deri në pikën që shkaktuan një panik mes depozituesve (Barisitz, 2001). Shkaku kryesor i këtyre krizave ka qenë dështimi i qeverive të këtyre vendeve në marrjen e masave ndaj paaftësisë paguesese të bankave, në një fazë të hershme të problemit. Autoritet e mbikëqyrjes nuk patën mundësinë të bënin më shumë se sa të paralajmëronin qeverinë për rrezikun e krizës bankare. Kështu për shembull, në Bullgari gjykatat e hodhën poshtë vendimin e bankës qendrore për t'i hequr licencat dy bankave për paaftësi paguese përpara krizës (Barisitz, 2001). Në Rusi, kriza bankare e vitit 1998 rodhi si pasojë e kolapsit të tregut të bonove të thesarit (Buchs, 1999). Edhe në rast se kapitalizimi dhe mbikëqyrja e bankave do të ishin në një gjendje më të mirë, kjo krizë mund të mos ishte evituar. Vendet e tjera të ish-Bashkimit Sovietik (me përjashtim të Republikës së Kirgistanit) nuk përjetuan kriza bankare pas kolapsit financiar në Rusi, kryesisht për faktin se ekspozimi i tyre ndaj tregut të bonove të thesarit të Qeverisë Ruse ishte shumë i vogël, si pasojë e madhësisë së vogël të sistemeve bankare të tyre (Barisitz, 2000a).

Krizat e njëpasnjëshme, që goditën vendet në tranzicion treguan se sa delikatë janë sektorët bankarë të këtyre vendeve. Pavarësisht nga shkaqet specifike të këtyre krizave, një ndër shkaqet e përbashkëta më të rëndësishme të tyre është dobësia e kuadrit rregullator. Debati i rregullimit bankar në vendet e zhvilluara, përqëndrohet kryesisht në gjetjen e rrugëve më të mira për të shmangur rrezikun e krizave pa shkaktuar shumë efekte anësore (lidhur me sjelljen e rrezikshme që nxisin ato tek bankat). Ky diskutim vlen edhe për vendet në tranzicion. Por fillimisht, ato kanë nevojë të krijojnë dhe të zhvillojnë mjetet e duhura për të mbikëqyrur dhe për të rregulluar në mënyrë efikase sistemin bankar. Kjo ka të bëjë me miratimin e ligjeve të reja për bankat, me futjen e sistemeve të reja të kontabilitetit, me krijimin e autoritetit mbikëqyrës dhe rregullator që mund të sigurojë zbatimin e tyre si dhe me nxjerrjen e rregulloreve të reja për të rritur qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Gati të gjitha vendet në tranzicion kanë nxjerrë dhe kanë përmirësuar ligjin e sistemit bankar në përputhje me realitetin e ri të ekonomisë së tregut (EBRD, 2001 f. 107-230). Gjithashtu, ato kanë filluar të zbatojnë sisteme të reja të kontabilitetit në përputhje me standardet ndërkombëtare, që i kërkojnë

bankave t'i klasifikojnë dhe t'i provigjonojnë aktivet e tyre (sidomos kreditë) sipas rrezikut.

Megjithatë, nxjerrja e ligjeve dhe e rregulloreve të reja bankare nuk është e mjaftueshme për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit bankar, në qoftë se këto rregulla nuk zbatohen (Juan, 1996; Wijnbergen, 1998). Në vendet në tranzicion ekzistojnë të paktën dy probleme lidhur me forcimin e funksionit rregullator dhe mbikëqyrës. Problemi i parë lidhet me mungesën e ekspertizës për të realizuar mbikëqyrjen e bankave. Supervizorëve të rinj ashtu si dhe bankierëve në vendet në tranzicion, u duhet kohë për të fituar aftësitë e nevojshme të ekspertizës bankare dhe të mbikëqyrjes. Problemi i dytë lidhet me izolimin (pavarësinë) e autoriteteve të mbikëqyrjes nga ndikimet politike si dhe me lidhjet e brendshme që cënojnë cilësinë e mbikëqyrjes.

Në shumë vende në tranzicion, bankave qendrore iu është dhënë dhe autoriteti mbikëqyrës, me përjashtime të vogla (si në Hungari, ku autoriteti mbikëqyrës është një agjenci e pavarur qeveritare). Eksperienca dhe teoria e perëndimit nuk japin një përgjigje të qartë përsa i përket mënyrës më të mirë për të mbajtur autoritetin mbikëqyrës. Juan (1996) dhe Bonin dhe Watchtel (1999) argumentojnë se në ekonomitë në tranzicion autoritetet mbikëqyrëse duhet të jenë agjenci të pavarura jashtë bankave qendrore. Përndryshe, objektivat makroekonomikë të bankës qendrore dhe roli i saj si huadhënës i fundit në rradhë, mund të konfliktojnë me objektivat e mbikëqyrjes bankare. Ky konflikt është më i mundshëm në vendet në tranzicion sepse kushtet e tyre makroekonomike janë më të paqëndrueshme se sa në vendet e zhvilluara. Megjithatë, në ekonomitë në tranzicion është e rëndësishme edhe pavarësia e autoriteteve mbikëqyrëse nga qeveria për zbatimin korrekt të kuadrit rregullator. Duke qenë se shumica e vendeve në tranzicion kanë zgjedhur modelin e bankave qendrore të pavarura, ekziston mundësia që pavarësia e tyre mund të ruhet më mirë brenda bankave qendrore sesa jashtë tyre, me kusht që pavarësia e kësaj të fundit të jetë arritur.

Në qoftë se qeverive apo gjykatave të vendeve në tranzicion u lihet dorë e lirë, ato mund të refuzojnë vendimet e bankave qendrore (apo të autoriteteve të mbikëqyrjes). Një fenomen i tillë mund të dobësojë reputacionin e bankës qendrore dhe për rrjedhojë aftësitë e saj për të zbatuar mbikëqyrjen bankare mbeten të kufizuara. Zgjidhja e problemeve të mbikëqyrjes bankare sidomos përmirësimi i aftësive mbikëqyrëse, mund të kërkojë kohë. Për rrjedhojë mund të argumentohet se, për të shmangur krizat bankare liberalizimi i sistemit bankar duhet shtyrë deri sa të arrihet një nivel i kënaqshëm mbikëqyrjeje. Nga ana tjetër, lejimi i hyrjes së bankave të reja dhe privatizimi i bankave shtetërore, do të thotë që një nivel paqëndrueshmërie është i pashmangshëm. Ashtu siç kanë argumentuar Gordon dhe Winton (1998) dhe Meyendorff dhe Snyder (1997), vënia e theksit të autoriteteve rregullatore vetëm mbi stabilitetin bankar mund të jetë jooptimale. Liberalizimi i hyrjes së

bankave të reja dhe nivelet e ulta të kërkesave për kapital, megjithëse gjenerojnë një numër të madh bankash të vogla dhe të rrezikshme, që rrisin paqëndrueshmërinë e sistemit bankar, janë të nevojshme për të rritur eficiencën e tij dhe për rrjedhojë, për të zhvilluar ndërmjetësimin financiar me një kosto më të ulët.

Ndërkohë, kjo pikëpamje nuk mbështetet nga eksperienca e vendeve të ish-Bashkimit Sovietik. Megjithë rritjen e madhe të numrit të bankave, zhvillimi i ndërmjetësimit financiar në këto vende mbetet nga më të ulëtit mes vendeve në tranzicion. Nga ana tjetër, eksperienca e vendeve të Evropës Qendrore, të cilat kanë nivelin më të lartë të ndërmjetësimit financiar mes vendeve në tranzicion, ka treguar se rritja e konkurrencës bazuar në hyrjen e bankave të huaja, nuk shoqërohet domosdoshmërisht me një paqëndrueshmëri më të lartë të sistemit bankar. Prandaj, në vendet në tranzicion duket se nuk ekziston një përfitim i qartë në lidhje me rritjen e ndërmjetësimit financiar duke rritur paqëndrueshmërinë e sistemit bankar. Mungesa e një shkëmbimi (trade-off) midis eficiencës së sistemit bankar dhe qëndrueshmërisë së tij, mund të shpjegohet dhe nga faktorë të tretë si stabiliteti makroekonomik, që mund të ndikojë si stabilitetin ashtu dhe efikasitetin e sektorit bankar. Kështu që sugjerohet se mund të ekzistojnë politika më të mira për të zgjeruar ndërmjetësimin financiar në vendet në tranzicion se sa vënia në rrezik e stabilitetit të tij.

Cilat janë rrjedhojat e problemeve të mësipërme të mbikëqyrjes për vendet në tranzicion sipas diskutimit teorik të rregullimit bankar? Futja e masave siguruese si, huadhënësi i fundit në rradhë apo skema e sigurimit të depozitave, rrit nevojën për një mbikëqyrje më të fortë të bankave për shkak të moralit të rrezikshëm që i shoqëron ato. Në rastin e huadhënësit të fundit në rradhë, banka qendrore mundohet ta shmangë problemin e moralit të rrezikshëm, duke vendosur një gjobë për çdo rast që bankat subvencionohen. Megjithatë, funksioni i huadhënësit të mundësisë së fundit, mbetet ende i paqartë. Në rastin e skemës së sigurimit të depozitave, problemi i moralit të rrezikshëm mund të shmanget me një normë të ndryshueshme të sigurimit të depozitave sipas rrezikut, e cila nga ana e saj kërkon një vlerësim të saktë të rrezikut të aktiveve të bankave. Një gjë e tillë, përveç një kuadri të plotë rregullator, kërkon dhe një teknologji të zhvilluar informacioni. Duke pasur parasysh nivelin e dobët të qarkullimit të informacionit në vendet në tranzicion, Wijnbergen (1998) argumenton se ekonomitë në tranzicion duhet të mbështeten në mekanizma direkt rregullues si norma fikse të sigurimit të depozitave. Prandaj, ato mund të mos arrijnë të shmangin problemet e moralit të rrezikshëm të gjeneruar nga futja e sigurimit të depozitave. Autorë të tjerë (Demirguç-Kunt dhe Detraigiache, 2000) kanë shkuar më tej, duke argumentuar se sigurimi i depozitave mund të jetë i parakohshëm për vendet në tranzicion në qoftë se ato nuk mund të përballojnë problemet e moralit të rrezikshëm. Boot dhe Wijnbergen (1995) argumentojnë se masa të tjera sigurie

si veprimtaria e kufizuar bankare, që mund të gjenerojë më pak probleme të moralit të rrezikshëm, janë më të përshtatshme për vendet në tranzicion. Sipas këtij propozimi, sigurimi i depozitave kufizohet vetëm për depozitat e qytetarëve në bankën e kursimeve, duke mbajtur të gjitha depozitat e tjera të pasiguruara. Megjithatë, të gjitha masat alternative të sigurisë në krahasim me sigurimin e depozitave, në një mënyrë apo në tjetrën, e kufizojnë aktivitetin e bankave dhe, për rrjedhojë, mbartin koston e zvogëlimit të eficiencës së tyre. Prandaj në këtë rast autoritetet mbikëqyrëse hasin një shkëmbim (trade-off) të qartë midis stabilitetit dhe eficiencës së sistemit bankar.

2. Mbikëqyrja bankare në Shqipëri

Më sipër pamë se një aspekt i rëndësishëm i reformimit bankar në vendet në tranzicion është mbikëqyrja bankare, që siguron qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e sistemit bankar. Kjo konsiston në zëvendësimin e ligjeve të vjetra me të reja, që i përshtaten më mirë ambjentit të ekonomisë së tregut si dhe krijimit të autoritetit mbikëqyrës që siguron zbatimin e këtyre ligjeve dhe nxjerr rregullore të reja për të siguruar stabilitetin e sistemit bankar. Në këtë kontekst, legjislacioni bankar shqiptar ka pësuar tre ndryshime të rëndësishme në vitet 1992, 1996 dhe 1998.

Ligji "Për Bankën e Shqipërisë" dhe ligji "Për sistemin bankar" i vitit 1992 ishin shumë të rëndësishëm përsa i përket ndarjes së sistemit monobank në dy nivele dhe vendosjes së bazave ligjore të një sistemi bankar në ekonominë e tregut. Ligji "Për sistemin bankar" të vitit 1996 ishte një përpjekje për të plotësuar dhe për të përmirësuar më tej ligjin e vitit 1992. Ky ligj ishte më i plotë se i mëparshmi në shumë aspekte. Ai specifikonte më mirë kërkesat për licencimin, për aktivitetin, për administrimin dhe për raportimin e bankave. Me ngjarjet e skemave piramidale lindi nevoja për përmirësime dhe për ndryshime të mëtejshme të ligjit, sidomos në lidhje me specifikimin e termit "bankë" dhe "aktivitet bankar". Kjo çoi në nxjerrjen e ligjit "Për sistemin bankar" të vitit 1998. Në këtë ligj u specifikua më mirë termi "bankë" dhe u shtuan ndalimet e përdorimit të kësaj fjale pa marrë licencë nga Banka e Shqipërisë (neni 26 i ligjit), u shtua detyrimi i Banka e Shqipërisë për të dalë me deklaratë në publik lidhur me ekzistencën e kërcënimeve në sistem, dhe u përcaktuan qartë masat që merren në rastet kur njësitë "jobankë" merren me aktivitete bankare apo mbledhin depozita nga publiku pa pasur licencën përkatëse.

Mbikëqyrja bankare në Shqipëri është ndërtuar kryesisht mbi parimet e BIS (I dhe II). Parimet e marrëveshjes së Baselit konsiderohen tashmë si standarde ndërkombëtare të mbikëqyrjes së shëndoshë nga vendet e zhvilluara si dhe ato në tranzicion. Megjithatë, ashtu si në vendet e tjera në tranzicion, në Shqipëri, zbatimi i mbikëqyrjes dhe i rregullimit bankar ka qenë i ngadaltë. Disa nga arsyet për këtë vonesë kanë qenë mungesa e mbikëqyrësve të

përgatitur dhe ndërhyrjet e qeverive të ndryshme në aktivitetin bankar (të bankave shtetërore). Mbikëqyrjet në vend kanë filluar të ndërmerren në mënyrë të rregullt që prej vitit 1995. Ndërkohë që, në përputhje me hyrjen në fuqi të ligjeve të reja, ka qenë i nevojshëm dhe rishikimi dhe nxjerrja e një sërë rregulloresh. Ky është një proces në zhvillim megjithatë, aktualisht, është arritur të krijohet një paketë e plotë rregulloresh për mbikëqyrjen bankare si ato të procedurave të licencimit të bankave, të shoqërive të kursim-kreditit, të zyrave të këmbimit valutor, të luftës kundër pastrimit të parave, për kapitalin e kërkuar etj.. Gjithashtu, kërkesa e kapitalit minimal për të hapur një bankë është rritur në 700 milionë lekë (≈ 5 milionë euro) nga 350 milionë në vitin 1997 dhe 200 milionë në vitin 1996. Edhe norma minimale për mjaftueshmërinë e kapitalit është rritur nga 8 në 12 për qind.

Duhet thënë se, megjithë vonesat e zbatimit dhe të forcimit të mbikëqyrjes bankare, sistemi bankar në Shqipëri deri më tani nuk ka përjetuar ndonjë krizë serioze, përveç rastit të vitit të kaluar (2002) të Bankës së Kursimeve. Megjithëse duhet thënë se kriza e Bankës së Kursimeve duket të mos ketë lidhje me gjendjen e saj financiare. Paniku ka qenë më shumë spekulativ, i nxitur nga komentet e disa politikanëve dhe të gazetarëve që shqetësuan depozituesit. Megjithatë, kjo ngjarje ka treguar se intrumentet e sigurisë bankare, si sigurimi i depozitave, kanë nevojë të fitojnë një besueshmëri përpara se të mund të shmangin rrezikun e krizave sidomos kur banka të mëdha si Banka e Kursimeve privatizohen.

Stabiliteti i sistemit bankar në Shqipëri mund t'i dedikohet deri-diku dhe strategjisë së mbështetjes në bankat dhe investitorët e huaj, për të reformuar sistemin bankar. Kjo mbështet argumentin, që rruga më e sigurt për të rritur konkurrencën dhe eficiencën e sistemit bankar në vendet në tranzicion është mbështetja në bankat e huaja. Përvoja e tyre me praktikat moderne të aktivitetit bankar dhe aftësitë drejtuese janë superiore dhe pozicionet e tyre të kapitalit, përgjithësisht, janë më të forta. Megjithatë, rasti i Bankës së Kursimeve tregoi se forcimi i rolit rregullator dhe mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar në të ardhmen. Megjithëse është shënuar një përparim i rëndësishëm në krijimin e kuadrit ligjor dhe në forcimin e mbikëqyrjes bankare, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar kualifikimin dhe reputacionin e mbikëqyrësve për të zbatuar në mënyrë efikase këto ligje dhe për të shmangur krizat e mundshme. Për këtë qëllim, objektivat dhe përgjegjësia e autoritetit rregullator dhe mbikëqyrës (Banka e Shqipërisë) duhet të respektohen me korrektësi, përndryshe reputacioni i saj mund të vihet në dyshim. Kështu, pavarësia e autoritetit rregullator dhe mbikëqyrës nga ndërhyrjet e mundshme të qeverisë duhet forcuar më tej. Autoritetet rregullatore, nga ana e tyre, duhet të mos kufizohen vetëm me kontrollet rutinë të bankave tregtare, por duhet të përpiqen të rrisin besimin e publikut në mbikëqyrjen bankare sidomos nëpërmjet fushatave edukuese si për shembull, shtimin e

publikimeve për këtë qëllim. Gjithashtu, kompetencat e organeve mbikëqyrëse në bashkëpunim me organet e tjera të drejtësisë, duhen zgjeruar më tej, nëpërmjet plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor, në marrjen e masave ndaj rasteve të papërgjegjshmërisë së disa mediave dhe gazetarëve (apo dhe politikanëve) në trajtimin e problemeve që mund të shkaktojnë panik të panevojshëm të popullsisë për sigurinë e sistemit bankar.

3. A është e nevojshme rritja e kapitalit minimal?

Në kuadrin e rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar në Shqipëri, kohët e fundit është hedhur dhe ideja për një rritje të mëtejshme të kapitalit minimal të kërkuar për licencimin e bankave, në rreth 1 miliard lekë (nga 700 milionë që është aktualisht). Le të shikojmë nëse kjo është një masë e nevojshme për të rritur sigurinë e sistemit bankar, bazuar në argumentet e parashtruara më sipër dhe në disa faktorë të tjerë që e karakterizojnë tregun bankar shqiptar.

Autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse në vendet në tranzicion kanë zbatuar në praktikë kriteret e marrëveshjes së Baselit si dhe raporte mjaftueshmërie kapitali në përputhje me këtë marrëveshje. Megjithatë, duhet thënë se këto kritere, përgjithësisht, janë ndërtuar në lidhje me kushtet e vendeve të zhvilluara në të cilat situata makroekonomike dhe institucionale si dhe cilësia e mbikëqyrjes janë në një nivel të kënaqshëm. Për vendet në tranzicion ku, si kushtet makroekonomike ashtu dhe ato të mbikëqyrjes bankare, siç u argumentua më sipër, lënë për të dëshiruar, mund të argumentohet se duhet të shkojnë përtej kritereve të Baselit për të siguruar një sistem bankar të qëndrueshëm e të krahasueshëm me atë të vendeve të zhvilluara. Në mënyrë të veçantë, ato duhet të aplikojnë kërkesa më të shtrënguara kapitali sesa kriteret e Baselit. Kjo mund të nënkuptojë si kapital minimal më të lartë të hyrjes ashtu dhe raport më të lartë të mjaftueshmërisë të kapitalit. Aktualisht, në shumë vende të tranzicionit përfshi dhe Shqipërinë, është aplikuar një raport më i lartë mjaftueshmërie kapitali prej 12 për qind (nga 8 për qind e marrëveshjes së Baselit).

Përsa i përket kapitalit minimial, marrëveshja e Baselit nuk jep ndonjë kufi specifik. Por Bashkimi Evropian, në "direktiven e dytë për bankat", përcakton se kapitali minimal duhet të jetë jo më i vogël se 5 milionë euro. Shumë prej vendeve të Bashkimit Evropian, si Franca, Gjermania kanë zgjedhur minimumin prej 5 milionë euro. Ndërkohë, disa vende në tranzicion si Republika Çeke dhe Hungaria kanë zgjedhur nivele më të larta (Tabela 1). Por, duhet thënë se këto vende mund ta kenë bërë një zgjidhje të tillë sepse janë karakterizuar nga kërkesa më të larta hyrjesh të bankave të huaja, dhe hyrje më të mëdha kapitali dhe investimesh të huaja, gjë që nuk është vërejtur në Shqipëri (të paktën deri më sot). Në Shqipëri, niveli aktual kapitalit të kërkuar është në minimumin e përcaktuar nga Bashkimi Evropian duke përmbushur kështu kushtin për hyrje. Prandaj, rritja e mëtejshme e kapitalit minimal do të duhet të justifikohet vetëm me rritjen e sigurisë që ai do të

mund të sillte. Por a është e nevojshme rritja e kapitalit minimal mbi atë të Bashkimi Evropian për të përmirësuar sigurinë e sistemit bankar në Shqipëri?

Një rritje e kapitalit minimal, nëse shoqërohet me transparencën e duhur, do të rriste besimin tek depozituesit sidomos në kushtet kur Agjencia e Sigurimit të Depozitave akoma nuk ka krijuar fondet dhe reputacionin e duhur për të shmangur ndonjë panik të mundshëm. Megjithatë, duhet thënë se masa e ndikimit të rritjes së besimit te depozituesit mbetet e diskutueshme.[2]

Siç u argumentua më sipër, një nga strategjitë e zgjedhura në Shqipëri për rritjen e konkurrencës së sistemit bankar pa e ulur ndjeshëm qëndrueshmërinë e tij, ka qenë mbështetja në bankat dhe investitorët e huaj. Një strategji e tillë ka gjetur mbështetje dhe në vende të tjera në tranzicion si dhe në literaturën bankare. Një mënyrë për të siguruar vazhdimësinë e kësaj strategjie, përveç privatizimit të Bankës së Kursimeve me investitorë strategjikë të huaj, do të ishte dhe rritja e kapitalit minimal. Kjo bazohet në argumentin se bankat dhe investitorët e huaj kanë mundësi më të madhe për të përballuar kërkesat e larta të kapitalit minimal në krahasim me investitorët vendas.

Tabelë 1: Nivelet e kapitalit minimal për vende të ndryshme

Vendet	Shuma e kapitalit minimal (në milionë usd)	Numri i bankave	Raporti Banka/milionë banorë
Vendet e Ballkanit			
Shqipëri	5,38	15.0	4.8
Maqedoni	2,2- 8,3*	21.0	10.3
Kroaci	5.4	46.0	10.5
Bosnjë Hercegovinë	4.3	63.0	15.8
Slloveni	4,0	29.0	14.6
Bullgari	4.5	34.0	4.3
Rumani	4,6	38.0	1.7
Jugosllavi	5,0	58.0	8.3
Mesatare	***4.8***	***38.0***	***8.6***
Vendet e Evropës Qendrore			
Republika Çeke	14.7	37.0	3.6
Hungari	8.0	38.0	3.8
Poloni	5.0	64.0	1.7
Mesatare	***6.5***	***51.0***	***6.3***
Vendet Balltike			
Estoni	5.0	7.0	5.0
Lituani	5.0	16.0	4.3
Letoni	5.0	23.0	9.5
Mesatare	***5.0***	***15.3***	***3.0***
Vendet e Eurozonës			
Gjermani	5.0	2,696.0	32.9
Francë	5.0	500.0	8.49
Itali	6.0	846.0	14.7
Greqi	18.0	61.0	6.1
Mesatare	***8.5***	***453.5***	***15.5***

Burimi: Faqe të ndryshme interneti të bankave qendrore. Shënim: * e pakonfirmuar.

[2] Është e rëndësishme të vlerësohet edhe fakti nëse media do të jetë në gjendje të tejçojë mesazhin e duhur duke mos shkaktuar keqkuptime, si në rastin e ligjit mbi "Sigurimin e depozitave".

Megjithatë, duhet thënë se niveli kapitalit minimal deri tani ka qenë frenues për investitorët vendas, ndonëse faktorë të tjerë si mungesa e punonjësve të përgatitur dhe marzhi i ulët i fitimit të këtij sektori (nga pikëpamja e biznesmenëve të mëdhenj) mund të kenë luajtuar rol të rëndësishëm për këtë plogështi. Megjithë prirjet e fundit të disa investitorëve vendas për të marrë licencë bankare, është e vështirë të besohet se një gjë e tillë do të mund të shkallëzohet në një bum hyrjesh të mëtejshme. Ndërkohë që rritja e nivelit të kapitalit mund të bëhet pengesë edhe për hyrjen e bankave të huaja të konsideruara si më të "sigurta", duke devijuar nga qëllimi për të cilin është marrë kjo masë. Gjithashtu, është e vështirë të llogaritet se cili do të ishte niveli i kapitalit që do të minimizonte hyrjen e investitorëve "të rrezikshëm" vendas duke ruajtur mundësinë e hyrjes së atyre të huaj.

Rrezikshmëria e investitorëve vendas për biznesin bankar, gjithashtu, është e nevojshme të analizohet me kujdes. Argumentat e përdorur pro bankave të huaja, mund të jenë njëkohësisht argumente kundër investitorëve vendas. Megjithatë, "shitja" në publik e një politike të tillë do të ishte e vështirë. Për sa i përket "shitjes" së politikës së rritjes së shumës së kapitalit minimal, një vështirësi tjetër lidhet dhe me sinjalin që ajo mbart. Një rritje e kapitalit minimal në përgjithësi, do të thotë se po tentohet drejt një sistemi më të përqendruar dhe me pak banka. Duke patur parasysh debatet aktuale mbi monopolet nuk do të ishte momenti më i përshtatshëm për ta paraqitur dhe mbrojtur.

Denduria e bankave në Shqipëri (banka për numër banorësh) nuk është shumë e ndryshme nga ajo e shumë vendeve të tjera në Evropë (Tabela 1). Gjithashtu, ritmi aktual i zgjerimit gjeografik të bankave ekzistuese duhet thënë se është i kënaqshëm, duke patur parasysh situatën makroekonomike dhe kuadrin ligjor. Por, megjithëse mund të duket optimale mbajtja e numrit të bankave në nivelin aktual, duhet patur kujdes me mesazhin që mund të marrin bankat ekzistuese. Ato mund të mendojnë se me rritjen e barrierave të hyrjes ato po izolohen nga konkurrenca potenciale. Kështu që, një rritje e kapitalit mund të ketë dhe efekte përkeqësuese përsa i përket sigurisë, duke patur parasysh sjelljen e rrezikshme që ai mund të shkaktojë.

Në praktikë, një rritje e kapitalit minimal në rreth 1 miliard lekë (*deklaratë e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë*) nuk do të përbënte problem të madh për bankat ekzistuese, duke qenë se shumica e tyre e ka kapitalin në këtë nivel apo afër këtij niveli siç mund të vërehet nga tabela 2, e cila paraqet informacionin në lidhje me: kapitalin rregullator, totalin e aktiveve të ponderuara me rrezikun, normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, kapitalin minimal të kërkuar në mënyrë që bankat të përballojnë madhësinë konkrete të riskut të ndërmarrë (në lidhje me normën minimale të mjaftueshmërisë të kërkuar prej 12 për qind), si dhe pjesa e tepërt e kapitalit të zotëruar nga bankat, pasi plotësojnë normën e kërkuar. Megjithëse duhet thënë, se

ekzistojnë disa banka të sistemit që kanë patur vështirësi në plotësimin e kapitalit edhe në nivelin e deritanishëm prej 700 milionë lekësh, pavarësisht nga raportet mjaft të larta të mjaftueshmërisë së kapitalit që ato kanë. Ndërkohë që, akoma më problematike rritja do të ishte për ato banka të cilat do të donin të ofronin shërbime të nivelit të dytë apo të tretë. Kështu, rritja e kapitalit minimal të paguar do të shkaktonte probleme të mëtejshme për Bankën Italo-Shqiptare dhe për Bankën Kombëtare Tregtare. Këto të fundit zotërojnë licenca të nivelit të tretë, që do të thotë plotësim i nivelit të kapitalit 3 miliard lekë me rritjen e kapitalit (nga 2.1 miliard lekë që është aktualisht).[3] Nga kjo pikëpamje rritja e kapitalit minimal mund të shikohet si pengesë për futjen e produkteve dhe të shërbimeve të reja në treg.

Tabelë 2: Gjendja aktuale e kapitalit të bankave që operojnë në Shqipëri (në milionë lekë)

	Kapitali rregullator (në milionë lekë) (A)	Totali i aktiveve të ponderuara me riskun (në milionë lekë) (B)	Norma e mjaftueshmerisë së kapitalit (ne %) (A) / (B)	Kapitali minimal i kërkuar, bazuar në normën prej 12% (C)=(B)x12%	Madhësia e tepërt e kapitalit zotëruar nga bankat (D)=(A) - (C)
BISH	1541.83	5928.14	26.01[4]	711.38	830.46
BK	2923.68	8972.91	32.58	1076.75	1846.94
BASHI	1274.34	1109.71	114.83	133.17	1141.17
BD	663.84[1]	307.90	215.60	36.95	626.89
BKT	1476.32	5112.12	28.88	613.45	862.86
BT	1530.05	10512.52	14.60	1261.50	268.55
BNT	659.18[2]	1173.74	56.20	140.85	518.33
ABA	1361.98	8396.72	16.22	1007.61	354.37
FEFAD	1063.94	4935.87	21.56	592.30	471.64
BTG	1376.64	1882.33	73.13	225.88	1150.76
BKG	760.37	2293.07	33.16	275.17	485.20
BA	1726.65	6258.88	27.59	751.07	975.59
BPI	721.40	655.83	110.00	78.70	642.70
BKSH	622.36[3]	478.69	130.00	57.44	564.92
CREDINS	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
TOTALI	*17702.58*	*58018.43*	*30.51*	*6962.21*	*10740.37*

Burimi: Banka e Shqipërisë; Shënime: 1: Nga ekzaminimi i plotë në vend, bankës i është rekomanduar plotësimi i kapitalit në 700 milionë lekë brenda datës 30.06.2003; 2. Në Bankën e Shqipërisë është sjellë shkresa përkatëse që konfirmon rritjen e kapitalit te kësaj banke në 6 milionë usd në datën 31 maj 2003; 3: Bankës i është dërguar shkresë formale, ku i kërkohet plotësimi i kapitalit baze në 700 milione lekë brenda datës 30.07.2003; 4. Bazuar në kontrollet më të fundit të Bankës së Shqipërisë ky raport është vlerësuar të jetë rreth 19%.

Problemi i plotësimit të kapitalit pas rritjes së kërkesës në rastin e Shqipërisë, thellohet dhe prej faktit se tregu aksioner, që është një rrugë e thjeshtë dhe e shpejtë për zgjerimin e kapitalit, mungon. Me fjalë të tjera kjo do të thotë që plotësimi i kapitalit duhet të realizohet me anë të kapitaleve të

[3] Zhvlerësimi i monedhës amerikane dhe rritja e konsiderueshme e fondeve rezervë për humbjet nga huatë janë dy faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rënien e kapitalit të bankave të mësipërme nën nivelin e kërkuar (Tabela 2). Për rastin e Bankës Kombëtare Tregtare-së Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi që t'i kufizojë të drejtën e disa aktiviteteve deri në fund të vitit, ndërkohë që Bankës Italo-Shqiptare i është kërkuar një plan masash brenda datës 4 korrik, sipas të cilit banka duhet të vërtetojë ngjarjet e shtimit të kapitalit brenda 6 muajve pas kësaj datë, në të kundërtën do t'i rishikohet niveli i licencës së dhënë.

huaja. Gjasa që bankat (investitorët) e huaja ekzistuese të dalin nga tregu pas rritjes së kërkesës së kapitalit, në rast se ato e shohin atë si shumë të lartë për ta plotësuar, është e vështirë duke patur parasysh investimet e tyre fikse. Por, nga ana tjetër, mund të argumentohet që një rritje e kërkesës së kapitalit mund të ulë interesin e investitorëve të huaj për privatizimin e Bankës së Kursimeve. Megjithatë, duke patur parasysh se Banka e Kursimeve është një bankë e madhe si nga ana e aktiveve ashtu dhe nga ajo e depozitave, blerësit e mundshëm duhet të jenë të përgatitur për të përballuar nivele kapitali shumë më të larta se ai minimal, pas fillimit të aktivitetit kreditues. Në këtë aspekt, për vetë rëndësinë që ka kjo bankë dhe suksesi i saj pas privatizimit, rritja e kapitalit duhet të shikohet më tepër si pozitive se sa negative.

Duhet thënë se sistemi bankar në Shqipëri karakterizohet nga një nivel relativisht i ulët kredidhënije në lidhje me PBB rreth 7 për qind, kur vende të tjera të tranzicionit këtë raport e kanë në 30-40 për qind, ndërsa vendet e zhvilluara në mbi 100 për qind. Kjo do të thotë se sistemi bankar, aktualisht, nuk është i ekspozuar shumë ndaj rrezikut të tregut dhe rritja e kapitalit minimal në këtë rast do të dukej si një masë e tepruar. Sistemi bankar në Shqipëri ka një raport mjaftueshmërie të kaptialit relativisht të lartë, prej 30.51 për qind (Tabela 2) krahasuar me normën minimale prej 12 për qind. Edhe sikur të parashikohet se kredia do të rritet në të ardhmen, nga disa llogaritje të përafërta del se vlera aktuale e kapitalit minimal prej 5 milionë euro është e mjaftueshme të përballojë një nivel kredi prej 14 për qind të PBB (duke supozuar që e gjithë kredia do të ponderohej me nivelin minimal të mjafueshmërisë së kapitalit prej 12 për qind). Ndërkohë që me kapitalin minimal prej 1 miliard lekësh mund të mbulohen gati 19 për qind kredi ndaj PBB-së, që është gati trefishi i nivelit aktual. Një nivel i tillë vështirë se do të arrihet në një të ardhme të shpejtë, ndërkohë që në një periudhë afatgjatë do të dukej më e realizueshme.[4] Kjo do të thotë që ndërkohë bankat ekzistuese të penalizohen sepse do detyrohen të mbajnë kapital më shumë sesa do të kërkonte rregullorja e Bankës së Shqipërisë për mjaftueshmërinë e kapitalit prej 12 për qind. E thënë ndryshe një rritje e kapitalit minimal do të zvogëlonte kthyeshmërinë nga kapitali i investuar (ROE) të tyre.

Në qoftë se mendohet se niveli prej 12 për qind i mjaftueshmërisë së kapitalit është i ulët për të siguruar stabilitetin e sistemit bankar, atëherë do të ishte më e preferuar një rritje e tij për këtë qëllim sesa rritja e kapitalit minimal të hyrjes. Rritja e mjaftueshmërisë së kapitalit do të ishte më fleksibël ndaj rrezikut që merr përsipër çdo bankë dhe rritet automatikisht me zgjerimin e

[4] Argumenti i mësipërm mund të shihet dhe në një këndvështrim tjetër të ngjashëm. Bazuar në kërkesat rregullatore për kapital me qëllim mbulimin e rrezikut që rrjedh nga portofoli i aktiveve, bankat e sistemit kanë tepricë kapitali. Kështu, ndërkohë që sistemit bankar i nevojiten rreth 6.96 miliardë lekë për të plotësuar kërkesën e mjaftueshmërisë së kapitalit në bazë të rrezikut aktual të aktiveve, ai [sistemi] zotëron rreth 10.74 miliardë lekë mbi kërkesën minimale. Në këtë mënyrë, detyrimi i bankave për të rritur kapitalin aktual, ndërkohë që ky i fundit është mëse i mjaftueshëm për të mbuluar rrezikun aktual të aktivitetit të bankave, do të përbënte një kërkesë të tepruar.

aktivitetit kredidhënës, duke mos penalizuar bankat që mund të përqëndrohen në investimet e sigurta dhe ofrimin e mjeteve të pagesës. Megjithatë edhe një lëvizje e tillë duhet të konsiderohet me kujdes. Duhet argumentuar qartë që një gjë e tillë mund të justifikohet për shembull, me situatën makroekonomike apo me problemet që mund të ketë mbikëqyrja në matjen e saktë të rreziqeve që ndërmarrin bankat.

Nga argumentet e mësipërme del se, rritja e kapitalit minimal të kërkuar, ndikimin e saj në sigurinë e sistemit bankar e ka më shumë në lidhje me shmangien e hyrjes së bankave të reja, të supozuara "të rrezikshme", sesa në përmirësimin e gjendjes aktuale të kapitalit të bankave ekzistuese[5], që mund të quhet e shëndoshë. Por, argumenti i përdorur për shmangien e bankave "të rrezikshme" për momentin nuk është shumë i fortë për rastin e Shqipërisë. Kjo për faktin se nuk është krijuar akoma një eksperiencë e mjaftueshme me bankat vendase për të konkluduar se ato përbëjnë një rrezikshmëri më të lartë për sistemin se bankat e huaja. Eksperienca e vendeve të tjera e mbështet më mirë argumentin e mësipërm, megjithatë duhet thënë se vështirësitë më të mëdha me bankat vendase, këto vende, i hasën kur kërkesa e kapitalit minimal ishte shumë më ulët nga sa është aktualisht.

4. Konkluzione

Me liberalizimin e sistemeve bankare në vendet e tranzicionit është rritur dhe rreziku i krizave. Kështu, shumë vende të tranzicionit janë prekur disa herë nga krizat bankare. Burimet e këtyre krizave, përgjithësisht, kanë qenë rezultat i kombinimit të politikave liberale të hyrjes së bankave të reja me dobësitë e kuadrit rregullator. Efektiviteti i kuadrit rregullator lidhet veçanërisht me problemet e zbatimit të mbikëqyrjes bankare. Këto probleme, kanë të bëjnë me mangësitë e supervizorëve të rinj për të matur në mënyrë të saktë rrezikun e ndërmarrë nga bankat dhe nga ndërhyrjet e qeverisë. Përballë një situate të tillë, vendet në tranzicion janë detyruar të aplikojnë masa më të larta sigurie se vendet e zhvilluara. Kështu, normat e mjaftueshmërisë së kapitalit në këto vende përgjithësisht janë më të larta se ato në vendet të zhvilluara.

Një argument i ngjashëm do të mund të përdorej dhe në rastin e kapitalit minimal hyrës në Shqipëri. Kështu, një rritje e kapitalit nga 700 milionë në 1 miliard lekë do të mund të justifikohej me arritjen e një stabiliteti më të lartë të sistemit bankar. Megjithatë, në këtë rast është e rëndësishme të theksohet vështirësia për të mbështetur një vendim të tillë. Argumentet pro-rritjes së mëtejshme të kapitalit minimal për momentin, përgjithësisht nuk janë shumë bindëse. Gjithashtu, përmirësimi i aspektit cilësor të kuadrit rregullator mund të jetë më i efektshëm se ai sasior (rritja e kapitalit). Elemente të tilla si, rritja e

[5] Dhe atyre që mund të hyjnë edhe pas rritjes së kapitalit.

pavarësisë së vendimmarrjes së mbikëqyrjes bankare, përmirësimi i aftësive të mbikëqyrësve, rritja e kërkesave për administratorët dhe për drejtuesit e bankave, kontrolli rigoroz i origjinës së kapitalit etj., përbëjnë, gjithashtu, faktorë të rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar.

Referencat

Barisitz, S. (2000a) "The development of banking sectors in Russia, Ukraine, Belarus dhe Kazakhstan since independence," *Focus on Transition*, Nr. 1 (Oesterreichische Nationalbank), f. 67-99.

Barisitz, S. (2000b) "The development of the Croatian banking sector since independence," *Focus on Transition*, Nr. 2 (Oesterreichische Nationalbank), f. 96-122.

Barisitz, S. (2001) "The development of the Romanian dhe Bulgarian banking sectors since 1990," *Focus on Transition*, Nr. 1 (Oesterreichische Nationalbank), f. 79-118.

Bonin, J. P., dhe Wachtel, P. (1999) "Toward market-oriented banking in economies in transition" in Blejer, M. I., dhe Škreb, M. eds. *Financial sector transformation: lessons from the economies in transition*, Cambridge University Press, Cambridge.

Bonin, J. P., Mizsei, K., Szekely, I. P., dhe Wachtel, P. (1998) *Banking in transition economies: developing market oriented banking sectors in Eastern Europe*, Elgar, Northampton MA, USA

Boot, A., dhe Wijnbergen, S. (1995) "Financial sector design, regulation dhe deposit insurance in eastern Europe," in Rostowski, J. eds. *Banking reform in Central Europe dhe the Former Soviet Union*, Central European Press, Budapest.

Buchs, T. D. (1999) "Financial Crisis in the Russian Federation: Are the Russian Learning to Tango?" *Economics of Transition*, Vol. 7, Nr. 3, f. 687-715.

Demirguç-Kunt, A., dhe Detragiache, E. (2000) "Does Deposit Insurance Increase Banking System Stability," IMF, Working Paper Nr. 00/3.

EBRD (2001) *Transition Report, 2001*, London 2001.

Green, D., dhe Petrick, K. eds. (2002) *Banking dhe Financial Stability in Central Europe*, Elgar Cheltenham.

Hansson, A. H., dhe Tombak, T. (1999) "Banking Crises in the Baltic States: Causes, Solutions, dhe Lessons," in Blejer, M. I., dhe Skreb, M. eds., *Financial Sector Transformation: Lessons from Economies in Transition*, Cambridge University Press, Cambridge.

Juan, A. (1996) "False friends in banking reform" in Fries, S. eds., Building sound banking in transition economies, EBRD, Working Paper Nr. 17, f. 36-47.

Meyendorff, A., dhe Snyder, E. A. (1997) "Transactional Structures of Bank Privatisations in Central Europe dhe Russia," *Journal of Comparative Economics*, Vol. 25, Nr. 1, f. 5-30.

Schardax, F., dhe Reininger, T. (2001) "The Financial Sector in Five Central dhe Eastern European Countries: An Overview," *Focus on Transition*, Nr. 1 (Oesterreichische Nationalbank), f. 30-64.

Wijnbergen, S. van (1994) *Eastern Europe after the First Five Years*, Amsterdam University Press, Amsterdam.

Wijnbergen, S. van (1998) "Bank Restructuring dhe Enterprise Reform," EBRD, Working Paper Nr. 29.